



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 19.09.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
HUAS DHE PROGRAMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT DHE KfW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT
“FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE IV””**

Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 19.09.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i Investimeve Sociale IV”, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Prezantimi i projektligjit

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin, znj.Brikena Jazxhi, Specialiste pranë ministries së ekonomisë dhe financave, dhe z.Emir Omari, përfaqësues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KfW Frankfurt am Main.

Këto ndryshime konsistojnë në shtyrjen e afatit të disbursimit, dhe rrjedhimisht ndryshimin e nenit 3.2 që parashikon afatin e fundit të disbursimit të fondeve në kuadër të kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu ndryshimi qëndron në zëvendësimin e emërimit “Ministria e Financave”, me “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

Akti parashikon propozimin e projektligjit për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas dhe programit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i Investimeve Sociale IV”, sipas tekstit të dokumentacionit ndryshues, dërguar nga KfW nëpërmjet letrës së saj drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Ndryshimi i propozuar i nenit 3.2 sjell shtyrjen e afatit të disbursimit për fondet e mbetura nga financimi i projektit “Fondi i investimeve sociale IV”, garancia e punimeve të së cilit ka përfunduar në qershor 2017. Duke qenë se procesi i përfundimit të procedurave rezultoi i pamjaftueshëm palët kanë dakortësuar për një shtyrje të mëtejshme të afatit deri më 30 tetor 2018, kohë kjo që do të bëjë të mundur disbursimin e fondeve të mbetura.

Efektet financiare

Ky projektligj **nuk ka** efekte financiare.

Efektet që sjell ndryshimi I propozuar I marrëveshjes së huasë qëndron vetëm në shtyrjen e afatit të përdorimit të kredisë së akorduar për projektin në fjalë.

Diskutimet në Komision :

Deputetët në komision u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit bazuar në pyetjeve dhe përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e ministrive. Pas sqarimeve nga përfaqësuesit e ministrisë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, komisioni votoi dhe miratoi në parim, nën për nën dhe në tërësi projektligjin.

Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i Investimeve Sociale IV”, është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.’”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi , me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI